LIGJ
Nr. 48/2014

PËR PAGESAT E VONUARA NË DETYRIMET KONTRAKTORE E TREGTARE[1]

(Ndryshuar me ligjin nr. 24/2015, datë 19.3.2015; nr. 64/2021, datë 20.5.2021; nr. 28/2023, datë 23.3.2023; nr. 81/2026, datë 23.7.2026)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Qëllimi i ligjit
(Ndryshuar me ligjin nr. 28/2023, datë 23.3.2023)

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për afatet dhe mënyrën e llogaritjes së kamatave ligjore për pagesat e vonuara në rastet e furnizimit me mallra apo shërbime nga ana e ndërmarrjeve tregtare kundrejt ndërmarrjeve të tjera tregtare dhe autoriteteve publike ose nga ana e prodhuesve bujqësore kundrejt ndërmarrjeve tregtare, në mënyrë që të sigurohet funksionimi i duhur i tregut të brendshëm, duke nxitur aftësinë konkurruese të ndërmarrjeve tregtare dhe në veçanti të ndërmarrjeve të vogla e të mesme.

Neni 2
Fusha e zbatimit të ligjit
(Shtuar shkronja "d" me ligjin nr. 24/2015, datë 19.3.2015)

Ky ligj zbatohet për të gjitha pagesat e kryera si kundërpagesë për veprimet juridike tregtare. Nuk i nënshtrohen rregullimeve të këtij ligji detyrimet apo pagesat:

a) që janë objekt i procedurës së falimentimit të çelur kundër debitorit, përfshirë edhe procedurën me objekt ristrukturimin e borxhit;

b) që rrjedhin nga kontratat me konsumatorët;

c) që lidhen me interesin apo pagesat e tjera të kryera për titujt;

ç) që lidhen me shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, përfshirë edhe pagesat e dëmeve nga shoqëritë e sigurimit.

d) që rrjedhin nga shitja, blerja dhe faturat e shërbimit të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, pa përfshirë pagesat që kryhen në tregun e parregulluar, sipas përcaktimeve të rregullave të tregut të energjisë elektrike.

---

[1] *Ky ligj është përafruar pjesërisht me direktivën 2011/7/EU, të Parlamentit Europian dhe Këshillit, të datës 16 shkurt 2011,"Për luftën kundër pagesës me vonesë në transaksionet tregtare"; Celex: 32011L000, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 48, datë 23.2.2011, f. 1–10.*

Neni 3

Përkufizime

(Ndryshuar pika 1 dhe shtuar pika 3/1 me ligjin nr. 28/2023, datë 23.3.2023; ndryshuar pikat 2, 3, 10, 11 e 12, shtuar pika 15 me ligjin nr. 81/2026, datë 23.7.2026)

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. 'Veprimi juridik tregtar' është kontrata apo çdo veprim tjetër juridik, përfshirë dhe faturën tatimore, i kryer ndërmjet ndërmarrjeve tregtare ose ndërmjet ndërmarrjeve tregtare nga njëra anë dhe prodhuesve bujqësore apo autoriteteve publike nga ana tjetër, të cilat çojnë në lëvrimin e mallrave ose realizimin e shërbimeve kundrejt një kundërpagese.

2. "**Autoritet publik**" është çdo autoritet kontraktor, siç përcaktohet në legjislacionin për prokurimin publik, pavarësisht nga objekti apo vlera e kontratës.

3. "**Subjekt tregtar**", në kuptim të këtij ligji, është çdo organizatë, person fizik ose juridik, me përjashtim të autoriteteve publike, që ushtron në mënyrë të pavarur një veprimtari ekonomike ose profesionale dhe që, në kuadër të kësaj veprimtarie, kryen transaksione tregtare. Në këtë kuptim, përfshihen, ndër të tjera, tregtarët, shoqëritë tregtare, si dhe organizatat jofitimprurëse që janë të angazhuara ose veprojnë në kuadër të një veprimtarie ekonomike ose profesionale të pavarur.

3/1. 'Prodhues bujqësor' është subjekti që zhvillon aktivitetin e vet në kuadrin e një sipërmarrjeje bujqësore, pyjore dhe peshkimi, i cili në zbatim të legjislacionit në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, është i pajisur me një numër identifikimi të personit të tatueshëm, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore, ku ushtron aktivitetin prodhuesi bujqësor.

4. "Pagesë me vonesë" është pagesa që nuk kryhet brenda afatit të përcaktuar me kontratë a me ligj, nga ana e subjektit tregtar dhe e autoritetit publik, kur janë përmbushur kushtet e parashikuara në nenin 4 të këtij ligji.

5. "Pagesë me vonesë e thesarit" është pagesa që nuk bëhet brenda afatit të përcaktuar me kontratë a me ligj, kur janë përmbushur kushtet e parashikuara në nenin 4 të këtij ligji, por kur ka gjendje me mungesë likuiditeti në llogarinë e unifikuar të thesarit pas datës së regjistrimit në sistemin informatik financiar të qeverisë.

6. "Sistem i thesarit", ky term ka të njëjtin kuptim me atë të parashikuar në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

7. "Kamatëvonesë ligjore për pagesën me vonesë" është kamatëvonesa e parashikuar nga ligji për pagesën me vonesë, me normë interesi të barabartë me shumën e normës bazë të interesit për lekun ose normës bazë të interesit për zonën euro, apo normës bazë të interesit në monedhë të huaj dhe, të paktën, tetë pikë përqindjeje dhe që llogaritet sipas nenit 5 të këtij ligji.

8. "Marrëveshje riblerjeje (REPO)" është marrëveshja, me anë të së cilës Banka e Shqipërisë shet titujt, duke marrë përsipër t'i blejë ato sipas kushteve për të cilat është rënë dakord paraprakisht me një bankë ose degë të bankës së huaj, me qëllim zvogëlimin e përkohshëm të likuiditetit në sistemin bankar.

9. "Marrëveshje e anasjellë riblerjeje (REPO të anasjella)" është marrëveshja, me anën e së cilës Banka e Shqipërisë blen titujt, duke marrë përsipër t'i shesë ato sipas kushteve për të cilat është rënë dakord paraprakisht me një bankë ose degë të bankës së huaj, me qëllim rritjen e përkohshme të likuiditetit në sistemin bankar.

10. "**Norma bazë e interesit për lekun**" është norma e interesit të marrëveshjeve të

riblerjes dhe të anasjella të riblerjes (REPO dhe REPO të anasjella), e miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, ose norma margjinale e interesit, që rezulton nga procedurat e ankandit me normë të ndryshueshme për këto operacione.

11. "**Norma bazë e interesit për zonën "euro"**" është norma e interesit të operacioneve kryesore të rifinancimit, e miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues të Bankës Qendrore Evropiane, ose norma margjinale e interesit, që rezulton nga procedurat e ankandit me normë të ndryshueshme për operacionet më të fundit kryesore të rifinancimit të Bankës Qendrore Evropiane.

12. "**Norma bazë e interesit në monedhë të huaj**" është norma e interesit të operacioneve kryesore të rifinancimit, e miratuar nga organet kompetente të bankave qendrore, që emetojnë monedhën, në të cilën është bërë pagesa, ose norma margjinale e interesit, që rezulton nga procedurat e ankandit me normë të ndryshueshme për operacionet e rifinancimit të këtyre bankave qendrore.

13. "Shuma për t'u paguar" është principali që duhej të ishte paguar brenda afatit ligjor ose kontraktor të pagesës, duke përfshirë tatimet, taksat, tarifat a detyrimet e zbatueshme, të përcaktuara në faturë ose në kërkesën e njëvlershme për pagesë.

14. "Urdhër ekzekutiv" është urdhri për vënien në ekzekutim të titujve të ekzekutimit, sipas nenit 511 të Kodit të Procedurës Civile.

15. "**Kamatëvonesë për pagesat e vonuara**" është kamatëvonesa ligjore për pagesën e vonuar ose kamatëvonesa me një normë të rënë dakord me marrëveshje ndërmjet subjekteve tregtare, në përputhje me nenin 13 të këtij ligji.

Neni 4

Veprimet juridike ndërmjet prodhuesve bujqësorë, subjekteve tregtar**e dhe autoriteteve publike**

(Shtuar fjalë në titull dhe në të gjithë nenin me ligjin nr. 28/2023, datë 23.3.2023)

Në veprimet juridike tregtare, ku debitori është një ndërmarrje tregtare apo një autoritet publik, kreditori, përfshirë këtu dhe prodhuesit bujqësorë, ka të drejtë që nga dita e nesërme, pas kalimit të afatit për kryerjen e pagesës, të përfitojë kamatëvonesë, pa qenë nevoja për t'i dërguar njoftim për vendosje në vonesë debitorit, në rastet kur:

a) kreditori, përfshirë këtu dhe prodhuesit bujqësorë, i ka përmbushur detyrimet sipas kontratës dhe ligjit dhe debitori nuk e ka kundërshtuar detyrimin;

b) kreditori, përfshirë këtu dhe prodhuesit bujqësorë, nuk e ka arkëtuar shumën për t'u paguar brenda afatit, me përjashtim të rastit kur përgjegjës për vonesën nuk është debitori.

Neni 5

Llogaritja e kamatëvonesës

1. Norma bazë e interesit për lekun, e zbatueshme për llogaritjen e kamatëvonesës është: Për gjashtëmujorin e parë të vitit, sa norma e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes (REPO dhe REPO të anasjella), miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë në mbledhjen e fundit të vitit paraardhës, duke i shtuar tetë pikë përqindjeje, dhe për gjashtëmujorin e dytë, sipas normës së miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë në mbledhjen e fundit përpara datës 1 korrik të vitit korrent, duke i shtuar tetë pikë përqindjeje.

2. Norma bazë e interesit për monedhën euro, e zbatueshme për llogaritjen e

kamatëvonesës, është:
Për gjashtëmujorin e parë të vitit, sa norma e interesit të operacioneve kryesore të rifinancimit, të miratuara me vendimin e Këshillit Drejtues të Bankës Qendrore Europiane në mbledhjen e fundit të vitit paraardhës, duke i shtuar tetë pikë përqindjeje, dhe për gjashtëmujorin e dytë, sipas normës së miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues të Bankës Qendrore Europiane në mbledhjen e fundit përpara datës 1 korrik të vitit korrent duke i shtuar tetë pikë përqindjeje.

3. Norma bazë e interesit për monedhat e tjera, e zbatueshme për llogaritjen e kamatëvonesës, është sipas llogaritjes në lekë të normës së interesit, duke marrë si kurs të llogaritjes në lekë të detyrimit, kursin e ditës që kërkohet pagesa e kamatëvonesës ligjore.

Neni 6

Afatet e pagesës dhe të drejtat e kreditorit në transaksionet ndërmjet subjekteve tregtare

(Ndryshuar me ligjin nr. 81/2026, datë 23.7.2026)

1. Në transaksionet tregtare ndërmjet subjekteve tregtare, kreditori ka të drejtë të përfitojë kamatëvonesë pa qenë i nevojshëm dërgimi i një njoftimi apo kujtese për pagesë, nëse janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

a) kreditori ka përmbushur detyrimet e tij kontraktore dhe ligjore;

b) kreditori nuk e ka marrë pagesën në afat, përveç rasteve kur debitori vërteton se nuk është përgjegjës për vonesën.

2. Përjashtimisht nga rregullat e përgjithshme të ekzekutimit të detyrimeve të parashikuara në Kodin Civil, dispozitat e këtij ligji rregullojnë në mënyrë të posaçme afatet dhe lindjen e së drejtës së kamatëvonesës për transaksionet tregtare.

3. Kur kushtet e pikës 1 të këtij neni janë përmbushur, kamatëvonesa llogaritet:

a) nga dita vijuese pas datës ose përfundimit të afatit të pagesës të përcaktuar në kontratë;

b) nëse data ose afati i pagesës nuk është përcaktuar në kontratë, me kalimin e:

i. 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së faturës ose e një kërkese ekuivalente për pagesë nga debitori;

ii. 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes në dorëzim e mallrave a shërbimeve ose e një kërkese ekuivalente për pagesë nga debitori, nëse data e marrjes së faturës është e pasigurt;

iii. 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes në dorëzim e mallrave a shërbimeve ose e një kërkese ekuivalente për pagesë nga debitori, nëse debitori e ka marrë faturën përpara marrjes në dorëzim të mallrave a shërbimeve;

iv. 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të procedurës së marrjes në dorëzim ose të kolaudimit të mallrave a shërbimeve ose e një kërkese ekuivalente për pagesë nga debitori, nëse një procedurë e tillë është e parashikuar me ligj ose në kontratë, dhe faturën debitori e ka marrë përpara ose në datën e kryerjes së këtij verifikimi.

4. Kohëzgjatja maksimale e procedurës së marrjes në dorëzim ose të kolaudimit të mallrave a shërbimeve nuk mund të kalojë 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data e marrjes në dorëzim të mallrave ose shërbimeve, me përjashtim të rasteve kur palët kanë rënë dakord shprehimisht ndryshe në kontratë dhe kjo zgjatje nuk përbën një kusht të padrejtë kontraktor, sipas nenit 10 të këtij ligji.

5. Afati i pagesës i përcaktuar në kontratë ndërmjet subjekteve tregtare nuk mund të kalojë 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike, përveç rasteve kur në kontratë është rënë dakord shprehimisht ndryshe dhe me kusht që ky afat të mos jetë qartësisht i padrejtë ndaj kreditorit.

Neni 7

Afatet e pagesës në transaksionet me autoritetet publike

(Ndryshuar me ligjin nr. 81/2026, datë 23.7.2026)

1. Në transaksionet tregtare, ku debitori është një autoritet publik, kreditori ka të drejtë të marrë kamatëvonesë ligjore pa qenë i nevojshëm dërgimi i një njoftimi, kur janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

a) kreditori ka përmbushur detyrimet e tij ligjore dhe kontraktore;

b) kreditori nuk ka marrë shumën e detyrimit në kohë, përveç rasteve kur debitori vërteton se vonesa nuk ka ardhur për shkak të rrethanave që nuk varen prej tij.

2. Kur afati i pagesës nuk është përcaktuar në kontratë, kamatëvonesa fillon të llogaritet automatikisht pas kalimit të afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh kalendarike, nga:

a) data e marrjes prej debitorit të faturës ose të një kërkesëpagese të njëvlershme;

b) data e marrjes në dorëzim të mallrave a shërbimeve, kur data e marrjes së faturës është e pasigurt ose kur debitori e merr faturën përpara mallrave ose shërbimeve;

c) data e përfundimit të procedurës së dorëzimit ose të kolaudimit nëse kjo procedurë parashikohet me ligj ose në kontratë, dhe debitori e ka marrë faturën përpara ose në datën kur kryhet ky dorëzim ose kolaudim.

3. Afati i pagesës i përcaktuar në kontratë nuk mund të kalojë 30 (tridhjetë) ditë kalendarike. Ky afat mund të zgjatet deri në një maksimum prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh kalendarike vetëm nëse është rënë dakord shprehimisht në kontratë.

4. Kur ligji ose kontrata parashikon një procedurë dorëzimi apo kolaudimi për verifikimin e konformitetit të mallrave a shërbimeve, kohëzgjatja e kësaj procedure nuk mund të kalojë 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data e marrjes së mallrave ose shërbimeve. Çdo kusht kontraktor ose dokument tenderi, që parashikon një afat më të gjatë, është i pavlefshëm.

5. Data e marrjes së faturës nuk mund të jetë subjekt i një marrëveshjeje kontraktore ndërmjet debitorit e kreditorit. Çdo kusht kontraktor, që synon shtyrjen e datës së marrjes së faturës është i pavlefshëm.

6. Kamatëvonesa llogaritet automatikisht nga dita e nesërme e përfundimit të afateve të përcaktuara në këtë nen, pa qenë nevoja për njoftim formal apo kërkesë vënieje në vonesë, sipas rregullave të përgjithshme të Kodit Civil.

Neni 8

Zgjatja e afateve për autoritet publike

(Shfuqizuar me ligjin nr. 64/2021, datë 20.5.2021)

Neni 9

Pagesat me këste

Për pagesat të cilat, sipas marrëveshjes së palëve, është parashikuar që të kryhen në periudha kohore të ndryshme, nëse ndonjëri prej kësteve nuk paguhet brenda datës për të cilën është rënë dakord, kamatëvonesa dhe dëmshpërblimi i parashikuar në këtë ligj llogariten në bazë të vlerave për këstin, të cilit i ka kaluar afati i kryerjes së pagesës.

Neni 10

Afatet e marrjes në dorëzim të mallrave ndërmjet subjekteve tregtare
(Ndryshuar titulli dhe togfjalësh në paragrafin e parë me ligjin nr. 81/2026, datë 23.7.2026)

Në ato raste kur, nga kontrata ose marrëveshja e palëve, është parashikuar që mallrat do të merren sipas një procedure dorëzimi apo në rastet kur duhet të bëhet kolaudimi i tyre, afati i marrjes në dorëzim apo i kolaudimit të mallrave nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë kalendarike. Ky afat fillon të llogaritet nga data e marrjes në dorëzim të mallrave ose shërbimeve nga blerësi.

Nëse në kontratën apo marrëveshjen e palëve është përcaktuar një afat tjetër, i ndryshëm nga ai i parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, ky afat do të quhet i vlefshëm, me kusht që, nisur nga natyra e mallit apo nga praktika tregtare, të mos jetë në dëm të interesave të kreditorit dhe të mos e vërë këtë të fundit në një pozitë diskriminuese.

Neni 11
Shpërblimi i shpenzimeve për rikthimin e kredisë

Kreditori ka të drejtë të kërkojë nga debitori jo vetëm pagimin në favor të tij të kamatëvonesës për moskryerjen e pagesës në afat, por edhe pagimin e të gjitha shpenzimeve të kryera prej tij për rikthimin e kredisë, shpenzime këto të kryera për shkak të pagesës me vonesë, përveç rasteve kur debitori nuk është në faj për vonesën.

Shpenzimet e parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni llogariten si kosto shtesë ndaj shumës që ka lindur për shkak të pagesës së vonuar dhe përfshijnë çdo shpenzim të provuar të kreditorit, që ai ka kryer kundrejt avokatëve, shpenzime të tjera ligjore të kryera për të bërë të mundur arkëtimin e pagesës, si dhe çdo shpenzim të paguar prej tij për të vënë në ekzekutim pagimin e shumës së detyrimit.

Neni 12
Pagimi i shpenzimeve

Në rastin e pagesës së vonuar, debitori ka detyrimin për të paguar në favor të kreditorit, përveç shpenzimeve të parashikuara në nenin 11 të këtij ligji, edhe një dëmshpërblim në shumën prej 5 000 (pesë mijë) lekësh. Kjo shumë është e pagueshme menjëherë, pa qenë nevoja e kryerjes së ndonjë njoftimi nga kreditori për pagimin e saj.

Neni 13
Kushtet kontraktore

Çdo marrëveshje që përjashton palët nga detyrimi për pagimin e kamatave, në rastet e pagesës së vonuar, është e pavlefshme.

Janë të padrejta dhe nuk krijojnë efekte juridike ato kushte kontraktore në lidhje me kushtet, afatet apo norma të tjera për llogaritjen e kamatëvonesave, si dhe për mospagimin e shpenzimeve për rikthimin e kredisë, sipas përcaktimeve të nenit 11 të këtij ligji, për aq kohë sa ato sjellin një dëmtim të shpërpjesëtuar të interesave të kreditorit dhe e vendosin këtë të fundit në një pozitë diskriminuese.

Për konstatimin e një kushti të padrejtë, sipas paragrafit të mësipërm, i cili përkeqëson gjendjen e kreditorit, duhet të merren në konsideratë të gjitha rrethanat e rastit, duke përfshirë:

a) çdo shmangie thelbësore nga praktika e mirë tregtare, e cila bie ndesh me parimet e mirëbesimit dhe paanësisë;

b) natyrën e mallit apo të shërbimit, me të cilin është furnizuar debitori;

c) faktin nëse ka arsye objektive që të sjellë për pasojë shtyrjen e afateve të kontratës, sipas parashikimeve të neneve 6 dhe 7 të këtij ligji; ose

ç) faktin nëse ka arsye objektive që të sjellë për pasojë shmangien në kryerjen e pagesës së parashikuar në nenin 12 të këtij ligji.

Neni 14

Pasojat e pavlefshmërisë së kushteve kontraktore

Në rast se një kusht kontraktor është i pavlefshëm, sipas nenit 13 të këtij ligji, kreditori ka të drejtë të kërkojë shpërblimin për dëmin e ardhur nga zbatimi i këtyre kushteve.

Nëse palët i kanë paguar njëra-tjetrës pagesa të llogaritura tej normave të përcaktuara në këtë ligj, pala e cila ka kryer pagesën, ka të drejtën e ngritjes së padisë së begatimit pa shkak, si dhe të kërkimit të shpërblimit për dëmin e ardhur.

Neni 15

Detyrimet e subjekteve tregtare para hyrjes në fuqi të ligjit

Parashikimet e këtij ligji nuk do të zbatohen për detyrimet monetare që kanë të bëjnë me furnizimet e kryera për mallra dhe shërbime ndërmjet subjekteve tregtare të lindura para hyrjes në fuqi të këtij ligji, por që nuk janë përmbushur ende dhe që për to nuk kanë filluar procedurat për vënien në ekzekutim të tyre.

Për detyrimet e parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni, për të cilat ka një vendim gjykate, kreditori nuk ka të drejtë të kërkojë pagimin e kamatëvonesave dhe pagesave të tjera që lidhen me rikuperimin e pagesës, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Neni 16

Titulli ekzekutiv

(Ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 81/2026, datë 23.7.2026)

1. Detyrimet monetare, të lindura nga veprimet juridike tregtare, të cilat nuk janë shlyer brenda afatit të pagesës përkatëse, sipas këtij ligji, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 485 i Kodit Civil, përbëjnë titull ekzekutiv dhe vihen ne ekzekutim nga përmbaruesi gjyqësor, pavarësisht vlerës, kur:

a) kreditori ka lëvruar mallrat apo kryer shërbimet sipas kontratës dhe ligjit; dhe

b) debitori nuk e ka kundërshtuar detyrimin.

2. Në këto raste, detyrimi së bashku me kamatëvonesat ligjore dhe/ose kontraktore dhe me dëmshpërblimin për shpenzimet për rikthimin e kredisë mund të vihen në ekzekutim të detyrueshëm, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile. Gjykata lëshon urdhrin e ekzekutimit brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së kërkesës në gjykatë, me kusht që deri në momentin e lëshimit të urdhrit të ekzekutimit, debia ose elemente të procedurës të mos jenë kundërshtuar nga debitori.

Neni 17

Detyrimet e autoriteteve publike para hyrjes në fuqi të ligjit

Për detyrimet e autoriteteve publike kundrejt ndërmarrjeve tregtare, të lindura dhe të paekzekutuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk zbatohen parashikimet e këtij ligji. Nuk mund të kërkohet zbatimi i parashikimeve të këtij ligji në rastet e ekzekutimit të detyrimeve, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, nga ana e autoriteteve publike dhe të lindura para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Dispozita kalimtare

(Parashikuar në ligjin nr. 81/2026, datë 23.7.2026)

1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen vetëm për transaksionet tregtare dhe kontratat e lidhura pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.
2. Për detyrimet e autoriteteve publike ndaj subjekteve tregtare, të lindura dhe të paekzekutuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk zbatohen parashikimet e këtij ligji. Këto detyrime rregullohen sipas dispozitave të ligjit në fuqi në kohën e lindjes së tyre.
3. Detyrimi për zbatimin e afateve të përcaktuara në nenin 7 të këtij ligji fillon 6 (gjashtë) muaj pas hyrjes në fuqi të tij. Gjatë kësaj periudhe, autoritetet publike, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për financat, hartojnë planin e shlyerjes graduale të stokut të detyrimeve.

Neni 18

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 24.4.2014

Shpallur me dekretin nr. 8568, datë 16.5.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani